



Nr. 1/41 prot.

Mora origjinalin sot me

dt. 22/09/2023

Elona Dibra

Shkodër, 22.09.2023

Lënda: Ankim për Vendimin e KB "Për një ndryshim në VKB nr. 71, datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër" (rialokim fondesh) i ndryshuar.

Drejtuar: Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër.

Baza ligjore: Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Ligjin Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 16 pika 2 gërma "b", (i), ligjin nr. 68/2017 Për financat vendore", ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar, Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar; Regullorja "Për konsultimin publik dhe marrëdhënien me median",

E nderuar, znj. Majlinda Angoni,
Prefekte e Qarkut Shkodër.

Me datë 13/09/2023 ditë e mërkurë, ora 17:00, është zhvilluar mbledhja e Këshillit Bashkiak Shkodër, me rend dite bashkëlidhur kësaj ankese. Rendi i ditës parashikonte për shqyrtim disa projekt vendime ndër to edhe projekt vendimin "Për një ndryshim në VKB nr. 71, datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të bashkisë Shkodër", i ndryshuar. Ky vendim është miratuar me shumicë votash, por ka disa shkelje ligjore, të cilat i kemi parashtruar fillimisht në konisionet e këshillit dhe në mbledhjen e dt. 13.09.2023, po i paraqesim më poshtë:

Së pari, ky projekt-vendim para se të shqyrtohej nga Këshilli Bashkiak, duhej të kalonte për konsultim me publikun, detyrim që pëcaktohet në nenet 18 e 54 gërma dh, e, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" si dhe neni 51 i

Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Shkoder. Sipas udhezimit të Rregullores për konsultim me publikun, Kryetari i Këshillit, në konsultim me Sekretarin e Këshillit, i paraqet Kryesisë së Këshillit propozimin për kalim në konsultim publik të projekt-aktit, kur ky i fundit klasifikohet si i tillë.

2. Kryesia e Këshillit merr vendim për kalim të projekt-aktit në proces konsultimi publik.

3. Kryetari i Këshillit i kalon projekt-aktin Komisionit të Përhershëm që mbulon fushën e veprimtarisë përkatëse, për planifikimin dhe realizimin e konsultimit publik, duke përcaktuar afatet përkatëse të realizimit të procesit.

4. Komisioni i Përhershëm shqyrton projekt-aktin dhe përgatit:

o Kalendarin e Konsultimit Publik

o Njoftimin e Konsultimit Publik

o Organizimin dhe drejtimin e takimeve publike.

o Cakton detyra për Sekretarin për njoftimin, organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit.

5. Sekretari i Këshillit (Sekretariati) asiston Komisionin në procesin e planifikimit dhe realizimit të konsultimit publik.

Bazuar tek Regullorja për Konsultimin Publik dhe mardhëdhënien me mediat, Njoftimi i Konsultimit Publik publikohet:

- Në faqen web të bashkisë/ Regjistrin elektronik të konsultimit publik
- Në mediat sociale zyrtare të Këshillit;
- Ju dërgohet grupeve të interesit nëpërmjet postës elektronike;
- Nëpërmjet mediave lokale (nëse ka të tilla).
- Duke e publikuar në gazetatat vendore (nëse ka të tilla).
- Nëpërmjet një lajmërimi publik, i cili afishohet në mjedise publike në qendër, lagje, njësi administrative, qendër fshati, nëpërmjet ndërlidhësit komunitar në lagjet e qytetit apo kryetarët e fshatrave, në rastet kur takimet bëhen në lagje apo fshat;

Gjatë konsultimit publik të realizuar nëpërmjet një takimi publik të cdo lloji forme, regullorja parashikon mbajtjen dhe bërjen publike të procesverbalit të takimit.

Qytetarëve u jepet kohë e mjaftueshme për të dërguar rekomandimet dhe mendimet e tyre në lidhje me çështjen që konsultohet.

Në zbatim të Rregullores “Për konsultimin publik dhe marrëdhënien me median”, përmbledhja e rekomandimeve:

I dergohet Kryetarit të Bashkisë për opinion;

I vihet në dispozicion Komisionit të Përhershëm të Këshillit të Bashkisë që duhet të trajtojë projekt- vendimin.

I dërgohet me postë elektronike çdo këshilltari

Bëhet publike në faqen e internetit të Këshillit /Regjistrin Elektronik

Pas dërgimit të përmbledhjes së rekomandimeve të grumbulluara gjatë procesit të konsultimit publik Kryetarit të Bashkisë, koordinimi midis Këshillit dhe Kryetarit përbën një element kyc në suksesin e procesit.

Në rastin konkret, perderisa ligji kerkon konsultim me publikun, duhej të hiqej nga rendi i dites dhe te zbatohet procedura ligjore per konsultim me publikun.

Së dyti, ky projekt- vendim që ndryshon buxhetin e vitit 2023 është miratuar pa miratuar më parë në Këshillin Bashkiak realizimin e buxhetit të vitit të mëparshëm dhe buxhetin faktik periodik sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr.68/2017 Për financat vendore", ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar," Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar; Udhëzimi Plotësues nr. 2 datë 19.01.2023 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023 i ndryshuar.

Së treti, ky projekt-vendim i miratuar vetëm me shumicë votash nuk ka transparencë sa i takon mënyrës se si do të shpenzohen. Fondi (rialokime) rreth 1 milion euro.

Një pjesë e këtij fondi shkon për:

- Blerje e pajisjeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit: kompjutera, laptop-ë, printera, aparate fotografike, dron, videokamera. Fondi total 10 milion lekë.

Nuk dihet, as nuk përcaktohet numër total për çdo pajisje që nevojitet të blihet e re. Nuk dimë sa kompjutera, laptop-ë, printera, videokamera, drone dhe aparate fotografike do blejë Bashkia me fondin prej 100 milion.

S'ka çmim reference, sa kushton secila prej pajisjeve që do blihen?! Sa kushton

1 kompjuter, 1 laptop, 1 printer, 1 aparat fotografik, 1 dron, 1 videokamera. Së katërti, ky miratim i ndryshimeve në buxhetin është votuar me shumicë votash. Deklarohet se janë 26 vota, por nga shpejtësia meqë ishte ndër pikat e fundit të rendit të ditës, ka dyshime se është kaluar pa plotësuar kuorumin e nevojshëm të votave që kërkohet që është shumica e cilësuar. Kësisoj në ushtrim të funksioneve tuaja në kontrollin e ligjshmërisë, nëpërmjet pamjeve filmike, të verifikoni edhe këtë pikë të votimit nga ana e shumicës faktike të cilësuar që kërkojnë ndryshimet e buxhetit sipas ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Sa më sipër, bazuar në Ligjin Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 16 pika 2 germa "b", (i), në Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8 pikat 1 dhe 2, neni 9, pika 1 germa "b" dhe pika 2, ktheni për rishqyrtim, Vendimin e Këshillit të Bashkisë Shkodër "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të bashkisë shkodër, i ndryshuar.

Me konsiderate,

Këshilltarët:

3/15 Dosë

Eliona Shkrela

Florian Bionin

Arben Haxhi

Elmira Novevashaj

Gjenerin Kapicari

Jonas Asmerogaj

Irma Kopliku

Valjeta Bagralitoni

Aleksander Pashuk



Andriy Behri

~~Be~~

Izmina Rusi

~~Be~~

Platent Anwalt

Be



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 421 Prot

Shkodër, më 06 09.2023

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së këshillit bashkiak

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Shkodër", i ndryshuar njoftoj thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër, në sallën e mbledhjeve të këshillit bashkiak ditën **Merkure, datë 13 Shtator, ora 17:00**, me rend dite si më poshtë:

1. Pr/ Vendim: "Për miratimin e mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak Shkodër, z. Gjenarin Kapcari"
2. Pr/ Vendim: "Për plotësimin e vakancës dhe dhënien e mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak Shkodër z. Erald Erkoçaj"
3. Pr/ Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Korrik 2023".
4. Pr/ Vendim: "Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira në administrimin e Bashkisë Shkodër për vitin 2023"
5. Pr/ Vendim: "Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social"
6. Pr/Vendim: "Për kalimin e mjetit ambulancë tek Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër, për Qendrën Shëndetësore Dajç"
7. Pr/Vendim: "Për një shtesë në VKB nr.71, datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të bashkisë Shkodër" të ndryshuar". (Paga)

8. Pr/Vendim: "Për një shtesë në VKB nr.71, datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të bashkisë Shkodër" të ndryshuar;
Për një ndryshim dhe shtesë në VKB nr.12 dt.20.07.2022 "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë".
9. Pr/Vendim: "Për një shtesë në VKM nr.71, datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të bashkisë Shkodër" të ndryshuar". (Tregu Rus)
10. Pr/Vendim: "Për një shtesë në VKM nr.71, datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të bashkisë Shkodër" të ndryshuar". (UNDP)
11. Pr/Vendim: "Për një ndryshim në VKB nr.71, dt.27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të bashkisë Shkodër" të ndryshuar. (rialokimi)
12. Pr/Vendim: "Për dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri".
13. Diskutime jashtë rendit të ditës.

Duke ju falenderuar,



Nr.	Komisione	Dita	Data	Ora
1	Komisioni për çështjet ligjore	E hene	11.9.2023	10:00
2	Komisioni i buxhetit	E hene	11.9.2023	11:00
3	Komisioni i mandateve	E hene	11.9.2023	12:00
4	Komisioni i shëndetësisë	E hene	11.9.2023	13:00
5	Komisioni i shërbimeve sociale	E hene	11.9.2023	14:00
6.	Komisioni i rendit publik dhe mbrojtjes civile	E hene	11.9.2023	15:00